

Cilat janë simptomat e sepsës?

Nuk ka vetëm një shenjë të sepsës, dhe simptomat paraqiten ndryshe te të rriturit dhe fëmijët.

Fëmijët

Çdo fëmijë mund të ketë sepsë në rast se:

- Ka frymëmarrje shumë të shpejtë
- Pëson një 'krizë' ose konvulsion
- Duket i larmë, kaltërosh, ose shumë i zbehtë
- Ka një skuqje e cila nuk venitet kur shtypet
- Është shumë letargjik ose zgjohet vetëm me vështirësi
- Ndihet jonormalisht i ftohtë kur preket

Lëkura me pigment më të errët mund të shfaqë ndryshimet e ngjyrës në zonat me më pak pigment, si p.sh. anët e brendshme të parakrahëve ose pëllëmbat.

Fakte kyç për sepsën

- Sepsa është reagimi i tepërt i sistemit imunitar ndaj një infeksioni ose plage
- Është jetike vëmendja e shpejtë mjekësore që të parandalohet dështimi i shumë organeve dhe vdekja
- Çdo vit, kjo gjendje prek 245.000 njerëz në Mbretërinë e Bashkuar, dhe merr 48.000 jetë
- Nuk mund t'i ndalojmë njerëzit të bëhen me sepsë, por ajo mund të mjekohet nëse zbulohet shpejt – kështu që është jetike ta dish se për çfarë duhet të rrish syhapur.

Të rriturit

Çdo i rritur mund të ketë sepsë nëse shfaq ndonjë prej këtyre shenjave dalluese:

- E folura e ngatërruar ose hutimi
- Dridhja ose dhimbja e skajshme e muskujve
- Mosurinimi (në një ditë)
- Gulçimi i rëndë
- Ndjenja sikur do të vdesësh
- Lëkura e larmë ose e zbardhur

Lëkura me pigment më të errët mund të shfaqë ndryshimet e ngjyrës në zonat me më pak pigment, si p.sh. anët e brendshme të parakrahëve ose pëllëmbat.

Çfarë duhet të bëj unë nëse dyshoj se ka sepsë?

Kërkoni urgjentisht ndihmë mjekësore.

Thirrni numrin 999 ose vizitoni **Repartin e Emergjencës te The Grange University Hospital** nëse dikush ka një prej simptomave të sepsës.

Nëse keni merak për ndonjë infeksion por nuk dyshoni për sepsën, thirrni numrin 111.

Pyesni thjesht, "Vallë mund të jetë sepsë?"

A do ta dinit të...

pyesni thjesht, "Vallë mund të jetë sepsë?"

Sepsa është gjendje kërcënuese për jetën, e cila merr **5 jetë në orë** në MB.

Mbi një e treta e të rriturve nuk do t'u shkonte ndërmend ta trajtonin sepsën si emergjencë, mirëpo ajo mjekohet shpesh me antibiotikë nëse zbulohet shpejt.

Dijenja më e mirë mund të shpetojë mijëra jetë çdo vit në MB.



Për më shumë informacione, skanoni kodin QR, ose vizitoni faqen abuhb.nhs.wales/sepsis ose sepsistrust.org



Bwrdd Iechyd Prifysgol Aneurin Bevan University Health Board



Bwrdd Iechyd Prifysgol Aneurin Bevan University Health Board

